



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.10.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Milva Ekonomi- nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 2 tetor 2019.
2. Seancë dëgjimore me zëvendësministren e Financave dhe Ekonomisë, zonjën Dajna Sorensen, për masat e marra për fillimin e vitit të ri shkollor 2019 – 2020 në sistemin parauniversitar të arsimit profesional.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjuzi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Adelina Rista, Kristaq Papa, Selami Jenishehri, Amra Borova dhe Klajdi Qama.

Mungojnë:

Vilma Bello dhe Enada Kapllani.

Të ftuar:

Dajna Sorensen – zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë,
Stavri Lako – përgjegjës sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,
Elira Demiraj – drejtore e Përgjithshme në Shërbimin Kombëtar të Punësimit,
Etleva Gjellaj – drejtore e Integritetit në Tregun e Punës dhe Formimit Profesional në Shërbimin Kombëtar të Punësimit.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri – Përshëndetje!

Mirë se erdhët në mbledhjen e radhës së komisionit!

Para se të vijojmë me rendin e ditës, a ka diçka për të shtuar për procesverbalin e datës 2 tetor 2019? A ka ndonjë koment?

Miratohet procesverbali.

Në rendin e ditës së sotme kemi seancën dëgjimore me zëvendësministren e Financave dhe Ekonomisë, zonjën Dajna Sorensen, për masat e marra për fillimin e vitit të ri shkollor 2019-2020 në sistemin parauniversitar të arsimit profesional.

Të ftuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë: zonja Dajna Sorensen, zëvendësministre, Stavri Lako, përgjegjës sektori, zonja Elira Demiraj, drejtore e Përgjithshme në Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe zonja Etleva Gjellaj, drejtore e Integritetit në Tregun e Punës dhe Formimit Profesional në Shërbimin Kombëtar të Punësimit.

Zonja zëvendësministre, ju ftojme të na prezantoni masat e marra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për fillimin e vitit të ri shkollor 2019-2020.

Fjala është për ju.

Dajna Sorensen – Përshëndetje të gjithëve!

Është kënaqësi që ndodhem sërish për një tjetër dëgjese për arsimin dhe formimin profesional në Shqipëri!

Arsimi i mesëm profesional është një alternativë reale dhe drejtimi i duhur për të rinjtë dhe të rejtat, sikurse edhe për të rriturit, që synojnë rikualifikimin, kualifikimin dhe integrimin në tregun e punës.

Arsimi profesional është gjithnjë e më tepër i orientuar drejt aftësive dhe nevojave të tregut të punës.

Në Shqipëri arsimi profesional ofron kualifikime të njohura në nivel kombëtar, të disponueshme dhe të ofrueshme për çdo familje dhe çdo shtresë shoqërore.

Investimi në arsimin profesional është ndër investimet më të sigurta, më eficiente dhe me një impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e biznesit dhe rritjen ekonomike të bondit, pasi u përgjigjet mungesave për punonjës të kualifikuar, nxit produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e kompanive, rigjallëron sektorët ekonomikë në rënie për shkak të mungesave në aftësi dhe nxit investimet e huaja në vend.

Të gjitha masat e ndërmarra për zhvillimin e arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri rrjedhin duke u bazuar në strategjinë kombëtare për punësim dhe aftësi 2014-2020.

Kjo është një strategji që shtyhet deri në vitin 2022 me një vendim të Këshillit të Ministrave, që besoj se do të kalojë brenda ditës së sotme.

Synimi kryesor është ofrimi i arsimit profesional cilësor, në radhë të parë, për të rinjtë, duke u krijuar atyre mundësi reale për t'u integruar në tregun e punës.

Do të doja t'ju jepja disa statistika për regjistrimet në arsimin profesional.

Në këtë vit të ri akademik, sipas të dhënave të fundit që disponojmë, që janë pak të përditësuara krahasuar me *memo*-n që ju është vënë në dispozicion, regjistrimet e reja në shkollat profesionale kanë arritur në 4832. Në total numri i nxënësi të regjistruar në arsimin profesional është 18 mijë e 500.

Përqindja e të rinjve që janë të angazhuar në arsimin e mesëm profesional, krahasuar me gjithë të rinjtë që janë në arsimin e mesëm të përgjithshëm, aktualisht është 20%. Pak a shumë, jemi në të njëjtin nivel me vitin e kaluar. Krahasuar me vitin 2013, kur përqindja e të rinjve që shkonin në arsimin profesional ka qenë 13-14%, kjo është një rritje domethënëse.

Kuptohet, jo të gjitha drejtimet në arsimin profesional janë njëlloj të pëlqyeshme dhe atraktive për të rinjtë. Ka disa drejtime që janë më të preferuara, konkretisht: hotelieri-turizmi është sektori ku ka më tepër kërkesa nga të rinjtë dhe të rejat, sidomos në disa prej shkollave tona të mëdha, ku kemi filluar të kemi edhe disa kufizime në numrin e personave që mund të regjistrohen. Degë të tjera të preferuara janë shërbimet e mjeteve të transportit, teknologjia e informacionit dhe komunikimit, ekonomi-biznes, elektro-teknikë, termo-hidraulikë, mekanikë dhe teknologji ushqimore.

Kemi disa shkolla që kanë një frekuentim shumë të lartë. Këto shkolla janë të përqendruara në Tiranë. Do të doja të nënvizoja dy shkolla në veçanti, që kanë një frekuentim shumë të lartë: shkolla "Hoteleri-Turizëm" në Tiranë dhe Shkolla e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit "Hermann Gmeiner", që notën mesatare të hyrjes dhe regjistrimit e kanë mbi 9,5.

Problematiche paraqitet situata në qarkun e Korçës, ku numri i të regjistruarve është goxha i ulët krahasuar edhe me historikun. Realisht, në totalitet Korça është një nga qarqet që nuk ka përjetuar rritje të numrit të nxënësve që ndjekin arsimin profesional. Krahasuar me rajonet e Tiranës, Durrësit, Elbasanit e të tjerë, Korça mbetet shumë mbrapa për sa i përket nivelit të regjistrimit të nxënësve.

Dobët paraqitet edhe Berati, ndërsa shkolla e Cërrikut është relativisht shumë e vogël. Këtë vit kjo shkollë është në rikonstrukcion dhe numri i nxënësve ka rënë pak krahasuar me një vit më parë.

Investimet në arsimin profesional vazhdojnë dhe janë të fuqishme, sidomos për sa i përket rikonstruksionit të godinave, bazave prodhuese të këtyre shkollave dhe pajisjes së tyre me laboratorë e mobilje.

Gjatë dy vjetëve të fundit kemi paraqitur një listë të të gjitha investimeve që janë ndërmarrë në shkollat profesionale qoftë në bazë prodhuese, qoftë në infrastrukturë e godina, sikurse kemi edhe programe, të cilat ose janë në fillim të punimeve ose do të fillojnë shumë shpejt në momentin kur ato do të transferohen në godina të tjera.

Është e rëndësishme të nënvizojmë faktin që shumë nga shkollat e arsimit profesional janë të mbështetura edhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë, të cilët kanë një historik të gjatë të mbështetjes së sektorit.

Mbetet sfida që praktikantët e mira që kemi me mbështetjen e donatorëve, të mund t'i ngremë në nivel sistemi.

Një nga zhvillimet kyçe që ka ndodhur në lidhje me arsimin profesional ka të bëjë me kuadrin legjislativ dhe institucional. Ligji i miratuar në 2017-n "Për arsimin dhe formimin profesional" linte detyrë për miratimin e një sërë aktesh nënligjore, një pjesë e të cilave patën mbetur peng i miratimit të ligjit për nxitjen e punësimit. Këto akte nënligjore tashmë janë në finalizim, pas miratimit të ligjit për nxitjen e punësimit në pranverë të këtij viti.

Nga ana institucionale, me miratimin e ligjit për nxitjen e punësimit dhe krijimin e Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi me vendim të Këshillit të Ministrave në fund të korrikut të këtij viti, menaxhimi i të gjitha shkollave i kalon kësaj agjencie dhe ato nuk do të kenë më varësi të drejtpërdrejtë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Prandaj, në këtë dëgjese kemi të ftuar edhe përfaqësues të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, që do të shndërrohet në Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi.

Përtej ndryshimeve infrastrukturore dhe atyre që përmenda në kuadrin ligjor dhe institucional, është shumë e rëndësishme ajo që kemi bërë për rritjen e kapaciteteve të mësuesve të lëndëve profesionale në sistem, që ka qenë edhe një element shumë i rëndësishëm i mbështetjes buxhetore sektoriale të Bashkimit Europian. Mbi 80% e mësuesve të lëndëve profesionale tashmë janë trajnuar, jo vetëm mësuesit, por edhe instruktorët e orëve profesionale.

Një rol shumë të rëndësishëm ka edhe Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet, që po punon për përditësimin e kurrikulave dhe programeve sipas nevojave të tregut të punës.

Gjatë vitit 2019 janë hartuar dhe përmirësuar 20 skelete-kurrikula. Gjithashtu, Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet, në bashkëpunim me ofruesit

publikë të APP-së, në kuadrin e garantimit të cilësisë, ka filluar procesin e vetëvlerësimit. Në fund të majit të këtij viti, siguroam që në të pesta fushat e garantimit të cilësisë të gjithë ofruesit e arsimit dhe formimit profesional të ndërmerrnin procesin e vetëvlerësimit.

Pak a shumë, këto ishin ato që doja t'ju prezantoja. Jam e hapur për çdo pyetje që mund të keni në vijim.

Fatjona Dhimitri – Para se të vijojmë me pyetjet, përfaqësuesi tjetër i ministries, ka gjë për të shtuar?...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk keni asgjë për të shtuar?

Atëherë, vijojmë me pyetjet dhe diskutimet për dëgjuesën e sotme.

Po filloj unë me pyetjet.

Zonja zëvendësministre, në informacionin shkresor dërguar nga ministria juaj për komisionin tone, flitet për kosto të përballueshme nga familjet.

Cila është kostoja e shkollës profesionale?

Ju lutem, shërbimi i komisionit t'i dorëzojë zonjës zëvendësministre një prej kopjeve të pyetjeve!

Zonja Zëvendësministre, në informacionin tuaj shkresor drejtuar shërbimeve të komisionit theksohet “kosto e përballueshme për çdo familje”.

Cila është kostoja e shkollës profesionale në raport me pagën minimale të një familjeje?

Cilat janë mesatarisht distancat që përshkojnë nxënësit për të arritur në shkollë?

A përballohet nga familjet me të ardhura minimale kostoja që kërkon një edukim profesional?

Pra, sa shkon kostoja e një studenti, që ndjek arsimin profesional, ku përfshihen transporti, detyrimet e shkollës, taksat e shkollës, librat dhe akomodimi, nëse vjen nga një qytet tjetër?

A ka Ministria e Financave një përlllogaritje minimale dhe maksimale në këtë drejtim?

Nëse kostoja nuk përballohet nga familjet, si parashikohet mbulimi i saj në qoftë se një nxënës kërkon të ketë një arsim profesional?

Për sa u përket regjistrimeve, në informacionin shkresor theksohet: “Janë regjistruar në vitet e para të shkollave profesionale rreth 4700 nxënës.” Pra, ky është një studim për vitin 2019-2020.

A keni një shifër të rakorduar se sa ka qenë numri i studentëve që kanë ndjekur studimet në vitet 2017-2018, sepse ju keni një numër që i referohet statistikave tuaja?

A mund të kemi një shifër zyrtare se sa ka qenë numri i studentëve, edhe në raport me përqindjet e parashikuara 13-14%, ku sipas të dhënave që ju mendoni se rezultojnë nga INSTAT-i, numri i nxënësve që kanë vazhduar arsimin profesional është rritur nga 13-14% në 20%? Pra, sipas jush, kemi një rritje me 7%.

Në informacionin tuaj shkresor theksohet se shkak i këtyre luhatjeve, pra, një herë kemi ulje të numrit të regjistrimeve, një herë rritje, një herë një numër constant, vjen sipas problemeve demografike dhe lëvizjes së lirë të njerëzve.

Çfarë nënkuptoni ju me lëvizje të lirë të njerëzve? Kuptohet që në vendet e Bashkimit Europian mund të lëvizim pa viza, por njerëzit nuk mund të vendosen aty, nuk kanë të drejtë të vendosen në vendet e Bashkimit Europian. Çfarë nënkuptoni ju me këtë? Ndoshta nënkuptoni emigracionin e paligjshëm?

Në informacionin tuaj shkresor keni paraqitur shifra për investimet që janë bërë në shkolla ose, më saktë, fondet limite të tenderave të prokuruar për këto shkolla, por nuk janë përcaktuar zërat e shpenzimeve.

Ku kanë shkuar gjithë këto investime?

Nuk e di sa të qeshura mund të shkaktohen, kur kërkohet llogari për një informacion të tillë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po vijoj me pyetjet, pastaj do t'ju jap fjalën.

Theksuat se në Korçë numri i nxënësve që ndjekin arsimin profesional është tepër i ulët dhe se në Berat e Cërrik ka probleme me regjistrimet.

Cilat janë masat që do të ndërmerreni ju si ministri?

Për sa u përket financimeve të donatorëve të huaj: Zvicra, Gjermania, Austria, cili është raporti i financimit të tyre në raport me buxhetin e shtetit? Si është bërë shpërndarja e tyre dhe e buxhetit të shtetit?

Lidhur me Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, a ka një studim fizibiliteti dhe çfarë ka dalë nga ky plan, përderisa planifikohen 100 mësues më tepër?

Gjithashtu, në fund të informacionit tuaj shkresor drejtuar komisionit tonë shihen projektet e donatorëve. Po u referohem investimeve që janë bërë në shkollat e Kamzës, ku në vitet 2017-2018 është parashikuar një investim prej 183 milionë e 440 mijë e 82 lekë, ndërsa për vitet 2018-2020 është parashikuar një investim prej 1 miliard e 270 milionë e 500 mijë lekë. Nëse vëzhgojmë raportin e investimeve, del që një investim i tillë është 4,5 herë më shumë nga fondi gjerman. Pyetja ime është: në çfarë gjendje kanë qenë këto shkolla apo qendra para vitit

2017? Pse është investuar një shumë e tillë kaq e madhe dhe pse është i nevojshëm një fond tjetër 4,5 herë më i madh për të njëjtat objekte?

Zonja zëvendësministre, në tabelën e dërguar në informacionin shkresor keni theksuar se janë bërë investime nga donatorët e huaj edhe për qendrat private të formimit profesional. Atëherë, cilat janë qendrat publike dhe private që kërkojnë fonde të tilla dhe si është bërë shpërndarja e këtyre fondeve?

Në buxhetin e shtetit u premtua një rritje 5% për arsimin. Këtë gjë nuk e shikojmë. Është bërë propagandë.

Mirela Kumbaro - Ku e keni dëgjuar këtë, sepse buxheti nuk ka ardhur ende?!

Fajtona Dhimitri – Është diskutuar një gjë e tillë.

Për sa u përket çmimit të librave, mendohet se janë shtrenjtuar mbi 7% këtë vit në raport me vitin e kaluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Urdhëroni!

Mirela Kumbaro – Faleminderit!

Duke iu falënderuar për pyetjet, më lejoni të sugjeroj që, kur flasim, do të ishte mirë të citonim edhe se nga e marrim burimin e të dhënave, sepse kur themi “mendohet”, nuk ...

Fajtona Dhimitri – Të dhënat janë marrë nga INSTAT-i.

Mirela Kumbaro – Atëherë, ose referohuni saktësisht, sepse “mendohet” nuk është burim.

Po kështu, kur ju thoni është premtuar për 5%...

Fajtona Dhimitri – Mirela, unë i kam drejtuar pyetjet për zëvendësministren. Kur të keni ju radhën, do t’jua jap unë fjalën të bëni saktësimet tuaja për buxhetin e përcaktuar.

Zonja zëvendësministre, mund të vijojmë.

Faleminderit!

Dajna Sorensen – Së pari, duhet t’i referohemi memos që ne kemi dërguar. Ne flasim për sistemin e arsimit dhe të formimit profesional. Pra, po flasim paralelisht, nga njëra anë, për shkolla profesionale, që janë shkolla të mesme profesionale, për arsim të mesëm profesional publik, që ofrohet falas ndaj të gjithë të rinjve dhe të rejave në Shqipëri, të cilët janë të interesuar të ndjekin arsimin e mesëm profesional. Ne flasim për kualifikim, por flasim edhe për rikualifikim. Kur flasim për rikualifikim, flasim për adultët, të cilët ndjekin kurse formimi profesional afatshkurtra, 1-6 muaj, pranë qendrave të formimit profesional. Këto nuk janë falas, por ofrohen me një kosto shumë nominale.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

....Përveç punëkërkesve të papunë, të cilët i përfitojnë falas të gjitha këto lloj kursesh.

Kemi përfaqësues edhe nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, që menaxhon qendrat e formimit profesional, të cilët mund t'ju japin vlera konkrete se sa janë kostot e trajnimeve profesionale në qendrat e formimit profesional, por po flasim për vlera shumë nominale, për kurse afatshkurtra. Për grupet vunerabël dhe për punëkërkesit e papunë këto kurse ofrohen falas.

Për sa i përket pyetjes që lidhet me distancën që përshkojnë studentët për të shkuar në shkollë, do të thosha se të gjithë studentët, të cilët nuk janë në gjendje të bëjnë transportin ose lëvizjen e përditshme nga shtëpitë e tyre, mund të qëndrojnë pranë konvikteve, të cilat ofrohen për nxënësit e shkollave profesionale.

Gjithashtu, është shumë e rëndësishme të themi se një pjesë e madhe e nxënësve të shkollave profesionale përfitojnë bursa, të cilat mbulojnë natyrën e këtyre shpenzimeve.

Pyetjet e tjera, ku përfshihet mbajtja e familjes, transporti e të tjera, më duken pa vend, sepse sapo u përgjigja.

Për sa i përket llogaritjeve minimale dhe maksimale, e përmenda që arsimit i mesëm profesional është falas, nuk ka minimum dhe maksimum.

Për sa i përket numrit të nxënësve, janë 4 mijë e 700 nxënës të regjistruar rishtasi, sipas memos që ne ju kemi dërguar. Megjithatë, ne jemi bazuar në të dhënat e fundit që kishim.

Për sa u përket të dhënave të përditësuar, unë e thashë në fjalën time, që numri ishte 4 mijë e 832, sipas të dhënave të fundit.

Ju përmendët pjesën e shifrave të INSTAT-it dhe pse ka një diferencë midis tyre, nëse e kuptova saktë pyetjen tuaj.

INSTAT-i, kur raporton, së pari, bazohet në të dhëna administrative. Kur i referohet shkollave profesionale, e ka fjalën edhe për Shkollën e Muzikës, Liceun dhe shkollat të tjera, të cilat nuk menaxhohen nga Ministria e Financave, por nga Ministria e Arsimit. Ato shifra janë në total. Kur unë them 13%-20% është e bazuar ekskluzivisht në të dhëna administrative, të cilat janë të mbledhura nga Ministria e Financave, krahasuar me numrin total të nxënësve që shkojnë në arsim të mesëm, qoftë profesional i përgjithshëm apo diçka tjetër, krahasuar me atë total ne na rezulton se nga 13%-14%, që ka qenë në vitin 2013, aktualisht është rritur në 20%. Vjet ka qenë 20,6%. Derisa të rakordohen përfundimisht numrat, të dimë edhe numrat e atyre që kanë hyrë në gjimnaze, do të jemi në gjendje ta vlerësojmë fiks, nëse është 20,2 apo 19,8. Por rreth 20% është shifra që ne kemi parashtruar.

Kur unë flas për lëvizjen e lirë të njerëzve, e kam fjalën për lëvizjet demografike të brendshme. Pra, nëse unë në Tiranë kam një rritje të madhe të popullsisë, nuk e kam këtë situatë

në Korçë, sepse në Korçë ka një lëvizje të brendshme, që ka çuar në një kërkesë shumë të shtuar në shkollat e Tiranës, në të cilat ne kemi lista pritjeje, ndërkohë që në Korçë janë pesë shkolla të vendosura shumë pranë njëra-tjetrës dhe secila në vetvete ka pasur vetëm regjistrime, që në këndvështrimin tonë janë relativisht të ulëta, nominale, në krahasim me pritshmëritë tona.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pyetja juaj për masat që ne do të ndërmarrim për nivelin e ulët të regjistrimeve është shumë e rëndësishme. Në rastin e Korçës ne po konsiderojmë një unifikim të ofruesve të arsimit dhe të formimit profesional në këtë qark, në formën e qendrave multifunksionale, të cilat ofrojnë edhe arsim të mesëm profesional në të njëjtat drejtime që aktualisht ofrohen, por edhe kurse afatshkurtra për të rritur. Normalisht, të vazhdojmë fuqishëm me promovimin e arsimit dhe formimit profesional në të gjitha qarqet, ku ka pasur një regjistrim relativisht më të ulët.

Për sa u përket financimeve të qeverive të ndryshme, që janë financime të huaja, për çdo projekt financimi të huaj, qoftë grant apo kredi që mund të jetë marrë, të gjitha marrëveshjet kanë kaluar në Kuvendin e Shqipërisë, të cilat ne kemi ardhur dhe i kemi mbrojtur këtu në mënyrë individuale. Se cili është raporti i financimit të huaj me buxhetin e shtetit, do t'jua kthej përgjigjen me shkrim, sepse nuk i kam këto të dhëna aktualisht.

Pyetjes nëse ka një studim vizibiliteti dhe çfarë ka dalë nga ky plan përderisa planifikohen 100 mësues më tepër, më lejoni të sqaroj se Agjencia Kombëtare e Arsimit Profesional dhe Kualifikimeve nuk ka lidhje me numrin e mësuesve, sepse është ekskluzivisht përgjegjëse për zhvillimin e kurrikulave në sistemin e arsimit dhe të formimit profesional. Janë dy ligje: ligji i punësimit dhe ligji i arsimit dhe formimit profesional, që ngarkojnë sistemin e ofruesve të arsimit dhe të formimit profesional me detyra, me funksione shtesë. Njëra prej këtyre strukturave është njësia e zhvillimit, që është një organ me 7 funksione brenda shkollave të arsimit dhe të formimit profesional, qoftë gjurmimi i nxënësve, qoftë praktikat profesionale që organizohen në kompani apo zhvillimi i vazhdueshëm i mësuesve të arsimit profesional e të tjera, të cilat kërkojnë burime shtesë njerëzore. Në 35 shkolla të arsimit profesional, me një variacion në bazë të numrit të nxënësve në secilën prej shkollave, u bë një planifikim i mirëfilltë i orëve mësimore shtesë, të cilat ishin të nevojshme për të mbuluar funksionet shtesë të dhëna sipas legjislacionit të miratuar në Kuvendin e Shqipërisë.

Për sa i përket pjesës së shkollës së Kamzës, u referohem investimeve që janë bërë me financimin e buxhetit të shtetit, do t'ia kaloj fjalën kolegut për përgjigjen.

Për sa i përket financimit gjerman bëhet fjalë për ndërtimin e *work shop*-ve shtesë, të cilat janë të domosdoshme për faktin që numri i nxënësve në shkollën e Kamzës është rritur, si në pak shkolla në Shqipëri. Nga një numër relativisht shumë i vogël para 7-8 vjetësh, aktualisht

jemi në shkollën më të madhe në Shqipëri, që ka rreth 1 mijë e 800 nxënës. Në momentin që ke 1 mijë e 800 nxënës, nevoja për laboratorë është tmerrësisht e lartë. Këtu flasim për laboratorë Cisco, laboratorë të megatronikës, të cilët janë tmerrësisht të kushtueshëm. Kjo marrëveshje me KfW-në është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, duke pasur të detajuara të gjitha zërat se ku do të shkojë dhe se ku konsiston ky financim. Përmenden shkolla dhe qendra private. I vetmi projekt që ka mbështetur qendrat private të formimit profesional është projekti *ProSEED* i GIZ-it. Në rastin konkret, ata kanë testuar një model të kontraktimit të shërbimeve të formimit profesional të një niveli më të avancuar në zona të pambuluara me shërbime publike të formimit profesional. Mund t'i drejtohem projektit për të marrë një informacion shtesë se cilët janë këta ofrues.

Fajtona Dhimitri – Fjala për ju.

Stavri Lako – Faleminderit!

Për sa i përket projektit, ai mbështetet në qendrat publike të formimit profesional, në 5 prej tyre, nga 10 që janë dhe që kryejnë aktivitete në vendin tonë. Logjika është se këto qendra nuk janë të shtrira në të gjithë territorin e Republikës, prandaj të kenë mundësi të përfitojnë formim profesional edhe individët, të cilët nuk e gjejnë këtë mundësi, për arsye se këto qendra nuk u ofrohen. Ndaj projekti ka planifikuar që përpos qendrave publike, të mbështesë edhe qendrat private.

Siç e përmendi edhe zonja zëvendësministre, shkolla e Kamzës ka një numër të jashtëzakonshëm nxënësish. Ajo ka dy godina në dispozicion, ku akomodohen nxënësit. Njëra prej tyre ishte në gjendje jo të mirë dhe u vendos të rehabilitohej. Më pas, është shumë apo pak, procedurat ndiqen nga një sektor i specializuar në ministri. Letrat janë dhe mund t'ju vëmë në dispozicion.

Fajtona Dhimitri – Pikërisht këtë do t'ju thosha.

Ju lutem, na jepni një informacion të detajuar për projektin e donatorëve për shkollat, kryesisht për shkollën e Kamzës ose tabelën e zërave dhe shpenzimeve, cilat kanë qenë ato. Këtë kërkesë e kam unë personalisht.

Stavri Lako – Projekti në Kamzës është ende në fazën e studim-projektimit.

Fajtona Dhimitri - Zërat e planifikuar të shpenzimeve, pra ku do të investohet për bibliotekën e shkollës, për laboratorët e për të gjitha.

Stavri Lako – E doni për projektin që presupozohet të financohet nga donatori?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Fajtona Dhimitri – Të gjitha informacionet.

Zonja Zëvendësministre, lidhur me investimet në shkollat e arsimit profesional, ku ju thoni se baza prodhuese e shkollës është investuar, përsëri do t'ju kërkoja një informacion, që të kemi një numër të qartë të laboratorëve, të bibliotekës së shkollës dhe ku kanë shkuar këto investime.

Përpara se t'ju jap fjalën, unë dhe zonja Mirela përfaqësojmë qarkun e Gjirokastrës dhe zonja Mirela është në dijeni sikurse ju, zonja Zëvendësministre, për shkollën e arsimit profesional “Thanas Papapano”, ku është projektuar një investim prej 150 milionë lekësh, ndërkohë që shkolla pothuajse është braktisur nga nxënësit. Ju e dini që janë regjistruar 150 nxënës, të cilët frekuentojnë shkollën. Është e rëndësishme të kemi investime për një arsim cilësor profesional, por përpara se të bëjmë investime të tilla kolosale është mirë të ofrojmë një qasje për nxënësit rreth arsimit profesional, ç'ka do të thotë të kemi profesorë më të përgatitur, pra të investojmë në përgatitjen e profesorëve për arsimin profesional.

Ismet Beqiraj – Zonja kryetare, për procedurë jepet direkt fjala.

Fatjona Dhimitri – Jo, do të ta jap fjalën, kur të mbaroj unë.

Ismet Beqiraj – E thotë Rregullorja, jo unë.

Fatjona Dhimitri – Mirë, urdhëroni!

Ismet Beqiraj – Ju, lutem, e kam për procedurë!

Fatjona Dhimitri – Zoti Beqiraj, nuk jua dhashë fjalën juve, iu drejtova zëvendësministres.

Ismet Beqiraj – Jeni e detyruar të ma jepni fjalën për procedurë në çdo kohë.

Fatjona Dhimitri – Jo, nuk jua jap fjalën, do ta merrni kur të keni për të bërë pyetje.

Zonja Zëvendësministre a keni një shpjegim lidhur me arsimin profesional?

Ismet Beqiraj – Të lutem!

Fatjona Dhimitri – Po përgjigjet eksperti.

Ismet Beqiraj – Në radhë të parë, ne duhet të japim modelin e respektimit të Rregullores, duke filluar nga ju.

Fatjona Dhimitri – Po flas unë, pastaj do ta merrni fjalën ju.

Ismet Beqiraj – Për procedurë do ta marr unë fjalën, në respekt të Rregullores.

Fatjona Dhimitri – Ju lutem ekspertëve dhe përfaqësuesve të japin përgjigje lidhur me investimin për këtë shkollë.

Ismet Beqiraj – Jo, jo, për procedurë do ta marr unë fjalën.

Fatjona Dhimitri – Jo!

Ismet Beqiraj – Harroje këtë gjë, se nuk shkelet Rregullorja!

Fatjona Dhimitri – Zonja Zëvendësministre, mund të flisni!

Ismet Beqiraj – Të lutem, se nuk shkelet Rregullorja!

Fatjona Dhimitri – Do të ta jap fjalën pastaj. Pse të ta jap tani?

Ismet Beqiraj – Jo, kur të dua unë!

Fatjona Dhimitri – Pse? Apo se t’u cenua ndonjë interes?

Ku shkuan këto investime?

Ismet Beqiraj – Çdo anëtar i komisionit duhet të marrë fjalën për procedurë dhe jo kur do kryetarja.

Fatjona Dhimitri – Ismet, ti e ke profesion të ndërhysh vend e pa vend. Po flas unë tani. Fjalën ta kam dhënë sa herë e ke kërkuar, sot do të ta jap më vonë.

Ismet Beqiraj – Ma ka dhënë Rregullorja këtë të drejtë, moj zonjë, nuk ma keni dhënë ju!

Fatjona Dhimitri – Ismet, unë i bëra një pyetje zëvendësministres.

Ismet Beqiraj – Kur një anëtar i komisionit kërkon fjalën për procedurë, ndërpritet seanca dhe jepet fjala. E thotë Rregullorja, jo komisioni, as unë dhe në respekt të Rregullores së ndryshuar do të më japësh fjalën.

Fatjona Dhimitri – Vazhdo!

Ismet Beqiraj – Nuk dua të paragjykoj pyetjet tuaja, por paraardhësja juaj në atë karrige kishte një model, pas shpjegimit të dëgjësave të gjithë anëtarët e komisionit bënin pyetje.

Fatjona Dhimitri – Unë nuk thashë që nuk do të ta jap fjalën, por që do të ta jap kur të mbaroj unë.

Ismet Beqiraj – Mos më ndërhy! Drejtuesja e komisionit bën të gjitha pyetjet e mundshme, që as kolegët e komisionit nuk i kanë të sigurta. Nga ana tjetër, ne e kemi thirrur zëvendësministren për dëgjësë për fillimin e vitit të ri arsimor dhe jo për buxhetet reale të vitit 2020 apo për buxhetin afatmesëm dhe afatshkurtër. Për këto do të diskutojmë gjerë e gjatë.

Ju lutem, të flasim lidhur me problematikat që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e këtij shërbimi publik shumë të rëndësishëm për edukimin, kualifikimin dhe përgatitjen e specialistëve, që i duhen tregut të punës në Shqipëri për vitin e ri shkollor.

Fatjona Dhimitri – Zonja Zëvendësministre, po jua paraqes sërish këtë kërkesë për një informacion të detajuar, por dhe drejtorëve e përfaqësuesve të tjerë, lidhur me investimin në shkollën profesionale “Thanas Papapano” në Gjirokastrë. Nëse e keni të pamundur të më jepni tani një ekspertizë të saktë, mund të ma dërgoni nëpërmjet shërbimeve të komisionit.

Stavri Lako – Ekspertizë të saktë jo, por dua të bëj një sqarim: në rikonstruksionin e shkollës “Thanas Papapano” është marrë në konsideratë të akomodohet edhe qendra e formimit

profesional, e cila ndodhet në një zonë që paraqet një rrezikshmëri dhe është pak e aksesueshme. Me këtë rast, duke rikonstruktuar shkollën është menduar që aty të akomodohet edhe qendra.

Edlira Demiraj – Nëse ka mundësi të shtoj pak informacion në kuadër të krijimit të Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, e cila do të trashëgojë shërbimet e punësimit, ndërkohë do t'i jepet edhe funksioni i menaxhimit të shkollave të arsimit profesional. Po bëj një ndërhyrje për më shumë shpjegim se çfarë do të ndodhë dhe si do të jetë procesi i menaxhimit të shkollave, dhe nga kush do të bëhet, pra procesi i qeverisjes, për të dhënë një perspektivë se çfarë do të ndodhë më tej.

Sot që flasim, shkollat administrohen ende nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Me krijimin e agjencisë, që u bë e mundur me ligjin që doli në korrik të vitit 2019, pavarësisht se ligji “Për arsimin profesional” e përcaktonte që do të ishte krijimi i agjencisë, e cila do të menaxhonte shkollat, ligji i dytë për nxitjen e punësimit doli në muajin prill të vitit 2019. Në këtë kuadër ne kemi krijuar agjencinë, ka dalë edhe VKM-ja për krijimin e kësaj agjencie, që do t'i menaxhojë. Ne i kemi vendosur tashmë tre objektivat kryesore. Në Strategjinë për Aftësi dhe Punësim kemi parashikuar se cilat do të jenë objektivat kryesore të menaxhimit të sistemit të arsimit dhe formimit profesional. Një nga pikat e para kryesore dhe që do të jetë plani i parë i punës është optimizimi i ofertës.

Sikurse u tha edhe në takim, lëvizja e lirë e qytetarëve është një proces jashtë kuadrit të menaxhimit institucional. E dyta, rritja e cilësisë së disa shkollave me laboratorë, me ofrimin e një cilësie të lartë të arsimit dhe formimit profesional, bën që nga vetë qytetarët shërbimi të kërkohej aty ku ka një cilësi më të mirë. Kjo na ka çuar në fillimin e një procesi konsultimi mes nesh, pra Ministria e Financës, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Agjencia për Nivelin e Kualifikimeve në Shqipëri, projektet e ndryshme të donatorëve që janë tashmë kontribuesit më të mëdhenj në këtë sistem, për të parë se si mund të optimizohet rrjeti i shërbimeve që ofrojmë. Mes të tjerave, janë Gjirokastra dhe Korça ku ne po marrim parasysh çdo faktor të mundshëm që të optimizojmë kërkesën në treg jo vetëm duke rritur cilësinë e arsimit profesional, por edhe ofrimin e formimit profesional, që është po aq i rëndësishëm, me qëllim që e gjithë ajo forcë pune në treg dhe që ka nevojë për një rikualifikim apo riorientim në karrierë, të gjejë një ofertë cilësore të arsimit dhe formimit profesional, e cila ka në bazë infrastrukturën, laboratorët, sepse është një nga elementet më të rëndësishme, ka ofertën cilësore, pra programin arsimor që zhvillohet aty, si dhe një instruktor të denjë që ta japë këtë shërbim. Ky optimizim dhe ky organizim do të bëjë të mundur edhe faktorin tjetër, shtrirjen rajonale.

Ju e cekët pak më parë që është edhe niveli i qasjes ndaj studentëve, edhe kjo është e vërtetë, por të gjitha eksperiencat, edhe ato ndërkombëtare, tregojnë që në fund të ditës arsimit profesional duhet organizuar aty ku organizohet më mirë, aty ku oferta jep maksimumin e produktit dhe pse jo të kombinohet me konvikte apo elemente të tjera, siç ndodh në të gjithë botën. Ndërkohë, formimi profesional është një element që do të afrohet shumë me qytetarin, sepse është me fleksibël, janë kurse afatshkurtra dhe janë në nivele pa ndërprerjen e punës, pra ai person që do ta ndjekë atë kurs, do të shkojë edhe në punë dhe pasdite të shkojë në kurs. Kështu që jemi duke parë optimizimin nga të gjitha këndvështrimet dhe kjo ndikon edhe pjesën e financimeve, që do të merret parasysh, pra çfarë ka ndodhur me to deri tani, për të mos bërë një riorientim jo të denjë, jo të përshpejtuar të të gjitha.

Edhe për qendrën e Gjirokastrës ne kemi filluar procesin që me asetin, inventarizimin e Qendrës së Formimit Profesional, verifikimin e truallit, verifikimin e problematikës për rrëshqitjet e terrenit gjatë një tërmeti, që ka ndodhur shumë vite më parë. Jemi në bashkëpunim me bashkinë. Po presim një studim fizibiliteti të bërë nga ata, nëse ia vlen të investohet në atë terren apo do të ketë përsëri defekte, pasi kemi të bëjmë me jetën e fëmijëve dhe nuk mund të marrim një vendim pa marrë këtë vlerësim. Paralelisht po shihet edhe mundësia që Qendra e Formimit Profesional të kombinohet me shkollën, me ofertën që do të jepet. Është një vendimmarrje që do kujdesin e vet, duke parë të gjitha këto parametra, se nuk mund ta marrim menjëherë. Ju siguroj se optimizimi dhe vendimmarrja do të jenë hapat e parë dhe do të ndodhë shumë shpejt.

Ne e kemi filluar tashmë punën, edhe pa e marrë funksionin për vlerësim.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Viojmë me pyetjet e anëtarëve të komisionit.

Po, zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – Faleminderit!

Meqë jemi te qarku i Gjirokastrës, do të më lejoni edhe një pyetje, që është më shumë për të kuptuar se si mund të funksionojë një përmirësim i situatave mes arsimit të përgjithshëm dhe atij profesional. Nëse e kuptova drejt, ju mbulon, sidomos me krijimin e kësaj agjencie, menaxhimin e rrjetit të arsimit profesional ekzistues. Si funksionon dhe çfarë hapësirash ka për një rishikim mes jush dhe Ministrisë së Arsimit për mundësinë e konvertimit të disa shkollave të mesme të përgjithshme, në funksion të interesit dhe të karakteristikave të zonës, në arsim profesional, për t'iu përgjigjur më mirë interesit të zhvillimit të asaj zone? E kam fjalën për shkollën e mesme të përgjithshme të qytetit të Libohovës, e cila në origjinë, në mes të viteve '70, ka qenë shkollë bujqësore dhe si e tillë ka qenë shkollë me emër, që iu përgjigjej nevojave

të zhvillimit bujqësor e blegtoral të rajonit. Unë nuk jam në gjendje t'ju them se në cilën periudhë, por është e sigurt që pas viteve '90 u kthye në shkollë të mesme të përgjithshme.

Nesër keni edhe 50-vjetorin e krijimit të kësaj shkolle.

Nga interesi i zhvillimit të zonës, i banorëve, i familjeve dhe i të rinjve, duke qenë se ajo zonë po kthehet në një tendencë agroturizmi gjithmonë e më të spikatur dhe po tërheq këtë lloj tregu të turizmit, ka shumë më tepër nevojë për formim profesional të kësaj natyre, agroturizëm apo qoftë edhe bujqësie, që e ndihmojnë shumë më tepër zonën sesa duke e mbajtur si një shkollë të mesme të përgjithshme, ku po ndodh ai fenomen që po ndodh në bashkitë periferike prej të paktën dy dekadash, ku tundimi është për t'i çuar fëmijët drejt gjimnazeve të qendrës dhe me këtë po i jap përgjigje edhe zonjës kryetare. Për shembull, nga Lazarati, Libohova drejt Gjirokastrës. Me përmirësimin e rrjetit infrastrukturor, rrugët e reja Lazarat-Gjirokastrë apo Libohovë-Gjirokastrë nuk janë më shumë se çerek ore apo 20 minuta larg dhe ka një tendencë njerëzore për t'i çuar andej. Nëse ne bëjmë një pol të ri zhvillimi në përputhje me nevojat e zonës, të heqim një kontingjent tjetër dhe t'i motivojmë ndryshe, bëjmë edhe formimin profesional të duhur, konkretisht formim me profil bujqësor dhe blegtoral.

Nëse ju do të më thoni që këtë shkollë e ka Ministria e Arsimit, ju kuptoj, por si i bëhet që një nevojë të tillë ju ta merrni në konsideratë, ta formalizojmë dhe të ecim përpara, për ta bërë të mundur në mos tani, më vonë. Shkolla ka mjedise, trupë pedagogjike dhe duhet të përpiqemi t'i rentabilizojmë më mirë.

Fatjona Dhimitri – A do të jepni përgjigje?

Po, urdhëroni!

Dajna Sorensen – Hapi i parë në këtë drejtim është të ndërmarrim një analizë të tregut të punës, që është një funksion drejtpërsëdrejti yni, të cilin mund ta bëjmë shpejt për të parë nëse realisht ka të gjithë ato elemente që ndërtojnë një *business case*. Ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë dhe mund ta angazhojmë Ministrinë e Arsimit, duke e futur në grupin e diskutimit për procesin e optimizimit të rrjetit, që drejtoresha përmendi pak më parë.

Fatjona Dhimitri – Po, zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Atëherë, ata kanë punën e tyre jashtë, kurse ne kemi punën tonë këtu dhe unë do të thosha vetëm dy fjalë. Zhvillimi dhe reforma në fushën e arsimit profesional sigurisht që është e mbështetur në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2014 dhe ju me të drejtë thoni që ta shtyni këtë periudhë. Edhe unë jam i mendimit që duhet shtyrë afati i kësaj strategjie.

Që ky zhvillim është bërë në përputhje të kësaj, tregohet edhe në informacionet që ju jepni, por edhe duke krahasuar raportimet dhe dëgjuesat që kemi bërë. Ky është viti i tretë që bëhet në prezencën tonë.

Krahasimet bëhen me shifra dhe ato janë kokëforta. Numri i nxënësve të regjistruar në arsimin profesional në vitin 2013 ka qenë 13% apo 14%, kurse në vitin 2019 është 20% e të gjithë nxënësve që mbarojnë klasën e nëntë dhe hyjnë në shkollat e mesme. Kjo tregon që pesha e rëndesës po shkon avash-avash drejt arsimit dhe formimit profesional, edhe për shkak të kërkesës që ka tregu i punës.

E dyta, ju me të drejtë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, nëse unë flas dhe paneli përballë flet, sikur ... Nuk jemi as në kafene dhe as në kinema.

Me të drejtë, pas 20 vjetësh është futur trajnimi në fushën e pedagogjisë i mësuesve dhe instruktorëve të këtyre shkollave, në mënyrë që profesionet e tyre, kryesisht të shkencave ekzakte, të përputhen edhe me formimin pedagogjik.

Në sa bashki, nga 61 të tilla në vendin tonë, janë hapur shkolla të arsimit dhe formimit profesional? Si ka qenë bashkëpunimi me organet e vetëqeverisjes vendore për këtë çështje?

Është hera e tretë që, vit pas viti, unë e bëj këtë pyetje, edhe pse në forma të ndryshme, sepse e kam shqetësim edhe për zonën elektorale që përfaqësoj, ku shtrihet dhe funksionon industria e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës. E mbështes propozimin që bëri kolegja ime, zonja Mirela, që shkolla e mesme në Mallakastër, në bashkinë Mallakastër, të rikthehet në traditë, sepse ka qenë një shkollë e mesme e bashkuar e përgjithshme dhe Teknikumi i Përpunimit të Naftës. Gjithashtu, kishte edhe profile të tjera. Duhet parë mundësia, sepse mjediset dhe mundësitë për transport janë. Transporti i nxënësve të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare, në Ballsh ka edhe shkolla qendër komunitare, do t'u vijë në ndihmë edhe nxënësve të tjerë, që do të kualifikohen dhe arsimohen në sistemin e profesioneve të industrisë së naftës.

Si specialist i fushës, unë e kam thënë me shqetësim dhe e them që kësaj industrie do t'i vijë "vdekja" nga largimi prej sistemit i personelit, sidomos personelit inxhiniero-teknik, që nuk po prodhohen më.

Me të drejtë ju thoni që ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri - Jo, mos e ndërpre fare.

Ismet Beqiraj – ... sepse janë tetë drejtime të preferuara. Në vazhdim të kësaj, si do të nxiten dhe hapen drejtimet e tjera, që nuk preferohen, sidomos në burimet energjetike, minerare dhe sektorë të tjerë? Do t'i lëmë këta pa specialistë? Nga do t'i marrim? Do t'i drejtohem tregut global? Ishte një lajm i mirë që gjysma e të punësuarve vitin e kaluar i përkiste Shqipërisë. Pse të mos e rrisim përsëri këtë trend?

Ju lutem, kjo iniciativë të parashikohet që në programin e këtij viti, jo vetëm për Mallakastrën, por edhe për kolegjen time që kam në krah.

Këtu u tha se në përputhje me kornizën shqiptare të kualifikimit, e cila ka në themel skelet-kurrikulat, vetëm për vitin 2019 janë realizuar dhe përmirësuar, unë kam punuar një kohë të gjatë me skelet-kurrikula, gati njëzet. Mbi bazën e tipologjisë së profesioneve të shpërndara në të gjithë Shqipërinë, keni ndonjë shifër konkrete se sa skelet-kurrikula ...?

Themi se i gjithë sistemi i arsimit nga klasa e parë në të dymbëdhjetën punon me kurrikulën e re. E njëjta gjë duhet të bëhet edhe me arsimin profesional, në mënyrë që edhe ky formim të adaptohet lehtësisht, jo vetëm në tregun e brendshëm, por dhe në tregun rajonal dhe europian.

Së treti, e shikoni si domosdoshmëri, në një kohë që numri i mësuesve, por edhe kualifikimi dhe trajnimi i tyre po rritet, që edhe për këta të bëhen ndryshimet përkatëse në ligjin e arsimit profesional, që të konkurrojnë në portal?

Së fundi, sistemi i arsimit dhe formimit profesional a ka kontrata për praktika profesionale në kompani të ndryshme, sikurse bëhet paralelisht me sistemin universitar? Ata do të punojnë në prodhim vetëm te baza teknike dhe eksperimentale në shkollë?

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Kolegë të komisionit, kjo nuk është hera e parë që kemi në dëgjuesë zonjën Dajna dhe të gjithë ata që shoqërojnë gjithmonë zëvendësministren në thirrjet e komisionit.

Dua t'ju sjell në vëmendje që ne kemi diskutuar për herë të parë me ju kur miratuam buxhetin. Të gjithë e dimë se që të bësh një bazë eksperimentale të një shkolle që merret me arsimin profesional, nuk është projekt i një viti, por vazhdon disa vite. Për ta kuptuar si shkonte kjo situatë kur miratuam buxhetin, ne përdorëm një instrument, që është kontrolli parlamentar. Ju lutem, që pyetjet që kanë të bëjnë me investimet, që i kemi dëgjuar më parë, t'i fusim te kalendari i kontrollit parlamentar, sepse nuk është ky momenti për të bërë këto pyetje.

Mos harroni që vjet në muajin maj kemi miratuar një projektligj për kurrikulat e kualifikimit. Kështu që, kini parasysh që ka edhe një impakt që kërkon pak më shumë afat. Kështu që, duhet të marrim përsipër që për këto gjëra që na shqetësojnë, të bëjmë thirrje për

një dëgjesë pas disa kohësh. Nuk mund të pyesim për një gjë që e dime, ndërkohë që nuk kemi parë se si është situata në terren.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri - Meqenëse Ismeti i drejtoi pyetjet, zonja Zëvendësministre mund të përgjigjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Përpara jush e ka kërkuar fjalën Fadili.

Bujar Çela – Kryetare, e kam kërkuar fjalën për procedurë.

Fatjona Dhimitri – Përpara jush e ka kërkuar fjalën Fadili.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, më vonë.

Bujar Çela - Nëse shkelni Rregulloren me Ismetin, me mua mos guxoni, sepse të gjithë kaloni nga Lushnja për të shkuar në Gjirokastrë!

Fatjona Dhimitri – Mos kërcënoni në mes të punës së komisionit.

Bujar Çela – Jam i detyruar, sepse ndryshe ju nuk ta jepni fjalën.

Fatjona Dhimitri – Shko kërcëno në partinë tënde, jo këtu me mua!

Bujar Çela – Partia ime është kudo.

Fatjona Dhimitri – Vazhdo, fol.

Bujar Çela – Kryetare, i drejtohem komisionit, por duke marrë guximin t’i bëj vërejtje shokut Ismet, i cili përmend me të drejtë Rregulloren, por po shkel Rregulloren.

Këtu jemi për çfarë është bërë për fillimin e vitit shkollor dhe jo për të rregulluar çfarë duam, kur na duhet, si i duam, si do t’i projektojmë. Është fat që zëvendësministrja ka marrë me vete edhe një emërtesë të re. Do të thotë që ne të ilumino kemi pak më shumë, ta specifikojmë problemin dhe jo të tregojmë përralla dhe histori naftë, minierash, kur do të bëhet në Ballsh. Nuk ka shkollë profesionale në Ballsh. Atje nuk ka më njerëz. Kanë ardhur të gjithë në Fier. Ismeti t’i drejtojë qytetarët të shkolla profesionale “Petro Sota”, që është një shkollë model. E rëndësishme është që ministria të shikojë problemin e investimit dhe të shtojë ambientet. Gjithashtu, të marrë në konsideratë shkollën “Rakip Kryeziu”, për të cilën të shtrohen të gjitha problemet, sepse mbulon një zonë shumë të madhe.

E treta, fabrikat e përpunimit të qumështit kanë sjellë në vëmendje kërkesën për përpunues të produkteve bujqësore dhe blegtorale, që koha i ka nxjerrë në skenë.

Turizmi kërkon kamarierë, pastičierë dhe profesionistë të tjerë. Pse duhet të marrin çertifikata false nga privati dhe të mos bëjnë shkolla shtetërore, të cilat kanë autoritetin, seriozitetin dhe kapacitetin për të prodhuar?

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – I kalove minutat e procedurës.

Po, Fadil.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vazhdoni! Mos na e bëni seancën qesharake.

Ismet Beqiraj - Edhe unë nuk di si ta kuptoj ndërhyrjen e Bujarit, por nuk është faji im që deri tani vetëm burime gazi janë zbuluar në Lushnjë, kurse burimet e naftës janë në zona të tjera. Sigurisht që unë do të flas për burimet e naftës, sepse kriza më e madhe energjetike në botë është ajo e naftës.

Fatjona Dhimitri – Zonja Zëvendësministre, keni ndonjë koment?

Dajna Sorensen – Jo.

Fatjona Dhimitri – Të ftuarit kanë ndonjë shpjegim apo jo?

Milva Ekonomi – Zonja kryetare, a mund t’i mbledhim të gjitha pyetjet bashkë?

Fatjona Dhimitri – Për kërkesat që unë parashtrova personalisht, por edhe pyetjet e anëtarëve të tjerë të komisionit, ju lutem përgjigjuni dhe na i dërgoni me një relacion të përgjithshëm pranë shërbimeve tona.

Fadil Nasufi – Duke i qëndruar rendit të ditës, që ka të bëjë me masat e marra për fillimin e vitit të ri shkollor edhe në arsimin profesional, unë kam vlerësim pozitiv për materialin e paraqitur nga zëvendësministria. Nuk duhet të jemi shumë të kënaqur me trendin që 20% e nxënësve të arsimit 9-vjeçar shkojnë në arsimin profesional, duke u ballafaquar me kërkesat e tregut të punës.

Qeveria ka dhënë mesazhe shumë të forta për arsimin profesional dhe ka dhënë edhe mbështetje financiare me investime, për të krijuar rrjetin e plotë të vënies në eficiencë të këtij arsimi.

Ne kemi premtuar 61 shkolla profesionale sipas profilit që ka secila bashki, por unë jam i mendimit për rajonizim, për shkak të zhvillimeve demografike dhe për shkak të trendit në rënie të nxënësve që nga arsimi parashkollor e deri te ciklet e larta. Duhet të jemi racionalë në këtë çështje. Duhet t’i shikojmë gjërat siç po ndodhin. Nuk i përgjigjet ritmit, kërkesës dhe programit të qeverisë baza poshtë. Me të drejtë zonja zëvendësministre thotë se në Berat ka rënë numri i nxënësve që ndjekin arsimin profesional. Ka ekipe dembelësh. Kjo ka të bëjë me kurrikulat, me qasjen, që është e ndryshme nga rekrutimi që i bëhet arsimit me portal në arsimin parauniversitar. Ngelen disa inxhinierë pa punë, gjejnë një qoshe dhe futen në punë. Ose pozicionin e instruktorit të hidraulikut, elektrikistit, e jep një me arsim të mesëm të moshës gati 60 - vjeçare. Ndaj, duhet përgatitur kuadri dhe specialistët e fushës sipas specifikave që kanë

shkollat profesionale, të cilat kanë edhe emër të trashëguar të viteve '30 si "Harry Fultz" apo shkolla bujqësore e Kavajës, por edhe në vitet e periudhës së komunizmit ka pasur profesionistë shumë të mirë. Ne sot kemi mungesa të ndjeshme në agrobiznes, bujqësi, specialistë të hotelierit-turizmit. Gjithashtu, t'u paraprijmë disa degëve, si nafta, që tha Ismeti, por nafta po zhvendoset në Berat.

Gjithashtu, edhe gazi është një degë e re. Duhet të ketë një shkollë të mirëfilltë profesionale në të gjithë pellgun e Myzeqesë me specialistë të kësaj fushe, që të bëhet studim dhe t'i paraprihet tregut të punës. Në të gjitha format prezenca e donatorëve ka qenë shumë e kënaqshme dhe me dinamikë, duke u marrë me trajnime, furnizimin e shkollave me bazë laboratorike dhe është treguar më shumë përkujdesje, në mënyrë që të ketë një produkt sa më të mirë nga shkollat profesionale, por ndonjëherë këto ngelen thjesht për *shou* dhe nuk kanë përditshmërinë e produktit, që duhet të dalë nga arsimi profesional.

Sa u takon shkollave të Beratit, prej 3 vjetësh në këto shkolla është krijuar një qendër e formimit profesional, e cila ka ngelur pa bazë laboratorike dhe pa kuadrin përkatës, që duhet të vihet në eficiencë. Ashtu siç është shkolla "Kristo Isak", e cila e ka një bazë prodhuese, por e ka thjesht si provë dhe të pazhvilluar, madje mund t'ju them se është e prapambetur, se mbajnë edhe disa bagëti atje, m'u në mes të qytetit, e cila stonon me jetën urbane të qytetit. Unë mendoj se këto prona duhet të rregjistrohen, të menaxhohen dhe të profilizohen si qendra eksperimentale me funksionet e reja dhe të mos jenë thjesht si vetërrjedhje. Kjo gjë mua më trishton. E kam pyetur drejtorin e shkollës "Kristo Isak": "Sa ka rënë numri i nxënësve?", ndërsa ai më thotë se do të largohen edhe 2-3 mësues. Pse në këtë mënyrë bëhet puna, duke ndenjur te dera e shkollës për t'u regjistruar apo duhet të dalin në terren dhe të bashkëpunojnë me qeverisjen vendore dhe të kërkojnë që këto shkolla profesionale të frekuentohen sa më shumë?!

Edhe lidhja me biznesin është thjesht formale. Bëhen disa seminare, të cilat më pas hidhen në *facebook* dhe duket sikur është bërë nami, por në vërtetë ky nuk është realiteti. Shkollat nuk funksionojnë realisht ashtu siç janë, pasi edhe pse ato bëjnë binjakëzime me shkolla të tjera, përsëri nuk janë funksionale, kjo është e vërteta.

Në Berat, në qendrën "Servis Center" do të vijnë të punojnë 500 kinezë, ndërsa ata që jetojnë atje, rrinë dha na bëjnë pritë kur dalim për xhiro se nuk ka punë, por e vërteta është se vetë ata nuk janë të përgatitur dhe nuk janë të formuar. Një tjetër problem është edhe ai që kanë rezervat me pagesat apo me informalitetin me tregun e punës. Në këtë mënyrë do të ecim përpara? Duke pritur nga asistenca sociale dhe duke ndenjur parazitë? Nëse qasja e arsimit profesional nuk shkon me Ministrinë e Financave, atëherë të rishihet dhe të gjendet një

zgjdhje, të jetë sa më shumë funksionale për arsimin profesional dhe nuk ka arsye përse t'i shtyjme. Qeveria jep paratë, jep alarmin, pasi edhe Kryeministri në çdo dalje të tij publike ka si shqetësim arsimin profesional, por kjo nuk duhet të jetë propagandë. Për çfarë jemi ne të tjerët? Të shohim një dembel që rri atje në krye të shkollës, i cili merr rrogën dhe thotë: “Kaq nxënës më erdhën në shkollë dhe kaq mësues do të heq nga puna”?! Ju duhet të jepni alarmin sa i takon kësaj çështjeje.

Fatjona Dhimitri – Zonja Rista e ka kërkuar fjalën.

Adelina Rista – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja zëvendësministre dhe ekipit tuaj për rezymenë e paraqitjes së fillimit të vitit të ri mësimor në arsimin profesional!

Pak a shumë të gjitha çështjet u prekën, prandaj do t'ju bëj vetëm një pyetje konkrete, që ka të bëjë me arsimin profesional bujqësor, me shkollat e mesme të profilizuara me drejtim bujqësor. Qyteti i Fierit e ka një shkollë të tillë, shkollën e mesme “Rakip Kryeziu”. Unë dua të di si ka qenë në rang republike regjistrimi i nxënësve në profilet agronomi, zooteknikë dhe veterinari? Sa është numri i nxënësve në raport me numrin e mësuesve në këto shkolla? Këtu jam dakord me kolegun parafolës, Fadilin.

Si është, duke pasur parasysh edhe vitet e kaluara, regjistrimi në fillim në këto klasa të këtij profili, agronomi, zooteknikë, veterinari në shkollat e mesme bujqësore dhe si del në fund të semestrit të parë në muajin janar? Mbahen fiktivisht me numër nxënësish fiktivë për t'i mbajtur klasat e hapura dhe numrin e mësuesve aq sa është, apo për t'i shtuar në mënyrë fiktive, sepse nuk ka portal, duke u kthyer në shkolla që bëjnë qoka për të papunët, apo nxënësit regjistrohen fillimisht dhe largohen duke e gjetur veten diku tjetër? Apo nuk janë në asnjë shkollë tjetër, por thjesht janë bërë regjistrime fiktive për të hapur klasa të këtij profili? I mëshoj fort kësaj çështjeje, sepse, nëse në shkollat e mesme të këtij profili në rang republike numri i nxënësve që regjistrohen në vit të parë është në ulje, atëherë neve na duhet të ndryshojmë politikat në këtë drejtim, të bëjmë një shkollë të mesme me profil bujqësor model në Republikë, që të tërheqë nxënës nga e gjithë Republika me konvikt e me të gjitha kushtet, por ama e dimë se kemi një shkollë të mesme me profil bujqësor në të gjithë Republikën, e cila është model dhe ne detyrimisht do të investojmë për të, jo të mbajmë klasa fiktivisht në shkolla të tjera.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Fjalën e ka zonja Xhembulla.

Almira Xhembulla – Faleminderit, kryetare!

Falënderoj, zonjën zëvendësministre dhe gjithë ekipin që e shoqëron për prezantimin shterues!

Nuk është hera e parë që unë ngre shqetësimin sa i takon shkollës profesionale “Nazmi Rushiti” në Peshkopi, por doja t’ju thosha se ishte pikërisht kjo shkollë ajo që zgjodha të vizitoja ditën e parë të shkollës, për të vetmen arsye që ne i kushtojmë një rëndësi shumë të madhe arsimit profesional, por edhe se drejtuesit janë shumë kërkues dhe stafi pedagogjik i kësaj shkolle është stafi më i mirë në krahasim edhe me shkollat e tjera të mesme të përgjithshme që ka qyteti.

T’ju them të drejtën, si deputete nuk ndihem e qetë dhe komode kur shkoj dhe vizitoj atë shkollë, për faktin që drejtuesit, stafi dhe nxënësit e saj meritojnë më shumë investime. Shkolla ka një infrastrukturë komode sa u takon klasave dhe laboratorëve, por nga pikëpamja e infrastrukturës është shumë e amortizuar. Gjithashtu, është edhe klasa për gjeologji, e cila është sateliti i shkollës në Bulqizë, që po funksionon mirë. Por sa i takon kësaj shkolle kisha një shqetësim, pasi maurantëve që mbaruan këtë shkollë nuk iu siguria një punë nga ana e “Albkromit”. Do të doja shumë që të shihet mundësia e një kontrate, të paktën për nxënësit që studiojnë aty, që të punësohen nga kompania apo institucionet që merren me minierën në Bulqizë.

Dua t’ju them se kur diskutova me stafin e shkollës edhe ata m’u shprehën se kishin folur me zëvendësministren, gjithashtu pashë edhe disa foto dhe projekte shumë të bukura, prandaj uroj që ta marrin në konsideratë faktin që lidhet me këtë shkollë. Nuk e di se çfarë argumentesh të tjera mund të ketë për ju te donatorët apo te qeveria, për një zonë, e cila është një ndër zonat më të varfra, ka numrin më të madh të njerëzve që marrin ndihmë ekonomike, e cila është shumë larg dhe nga pikëpamja infrastrukturore duhet të ketë patjetër një shkollë të mirëfilltë të arsimit profesional.

Në këtë zonë kishte një rënie të numrit të nxënësve, arsyeja ishte hapja e dy shkollave të mesme, të cilat nuk kishin një koordinim të plotë në mes tyre, por mendoj se ky ishte një gabim i qeverisjes lokale, që u korrigjua. Unë besoj se të gjitha ato shkolla që kishin një zvogëlim të numrit të nxënësve do të plotësohen, duke qenë se edhe menaxhimi i konviktit nga ana e bashkisë dhe drejtuesit e shkollës do të bëhet në mënyrë më korrekte.

Ju lutem, kërkoj që këtë çështje ta merrni në konsideratë dhe të keni një plan konkret sa i takon shkollës profesionale “Nazmi Rushiti”!

Gjithashtu, jam dakord me komentin që bëri Adelina sa u takon degëve si agronomi, zooteknikë, pyje dhe të gjitha degët e tjera që lidhen me këto profile.

Nga diskutimet që kam pasur me zyrën rajonale të bujqësisë, shumë shpejt nuk do të kemi më ekspansionistë në zonë, prandaj mendoj se këtë çështje duhet ta merrni në konsideratë.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – A ka diskutime të tjera?

Nuk ka.

A kanë përfaqësuesit e ministrisë ndonjë gjë për të shtuar?

Dajna Sorensen – Sa u takon pyetjeve, një pjese të tyre do t'u përgjigjem unë, pastaj kolegët do të plotësojnë pjesët e tjera.

Nga diskutimet që lindin, dalin dy mesazhe, të cilat deri diku janë kontradiktore me njëra-tjetrën. Nga njëra anë flasim për ekspansion të shkollave në 61 bashki dhe, nga ana tjetër, flasim që kemi nevojë për një optimizëm dhe përqendrim atje ku resurset janë më cilësore, aty ku oferta mund të jetë më e mirë.

Po e nis me pyetjet që bëri zonja Adelina sa i takon bujqësisë. Po, ne sot kemi 7 ofrues të arsimit profesional në fushën e bujqësisë. Detajimet sa i takojnë agronomisë, pyjores apo zooteknikës e të tjera më duhet t'ju japim në vijim, pasi nuk i kam me vete të dhënat në këtë moment. A kemi aktualisht probleme me *drop out*-in e nxënësve në arsimin profesional? Absolutisht që po. A e kemi këtë problematikë më të lartë në drejtimin e bujqësisë sesa në drejtimet e tjera? Jo! A e kemi nivelin e *drop out*-it në arsimin e mesëm profesional më të lartë sesa niveli i largimit në arsimin e mesëm të përgjithshëm? Përgjigjja është jo! Është i njëjti trend, të cilin e vëmë re edhe në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe atë profesional.

Sa i takon pjesës së shtimit të profilit të përpunimit të produkteve bujqësore, teknologji ushqimore e të tjera, ka iniciativa reale, që kanë ardhur në bashkëpunim me sektorin privat, i cili shpreh në mënyrë eksplicite nevojën për një profil të caktuar; atëherë ne kemi hapur profile të reja. Nëse ne nuk e kemi këtë informacionin nga tregu i punës që ky profil është i kërkuar, si dhe nuk kemi mjaftueshëm nxënës, të cilët nuk janë të interesuar të hyjnë në atë degë, ne nuk mund t'i marrim nxënësit me dhunë për të hyrë në një degë të caktuar. Është e domosdoshme që interesi të jetë nga të gjitha palët e përfshira në këtë proces.

Po ju jap një shembull. Ne hapëm në qytetin e Lezhës profilin e përpunimit ushqimor këtë vit. Pse? Sepse sektori privat u mblodh së bashku me shkollën dhe treguan në mënyrë eksplicite nevojën që ata kanë për persona të kualifikuar në këtë fushë. Madje, kanë shprehur interesin për ofertë edhe pas shkollës së mesme në këtë profil.

Sa i takon pjesës së përdorimit të portalit për mësuesit, jam 100% me ju. Ne jemi duke e ndryshuar udhëzimin në mënyrë radikale, që të gjithë mësuesit e lëndëve të përgjithshme të vijnë vetëm nga portali. Ministria ka firmosur javën e kaluar një urdhër që u është dërguar të gjitha shkollave, të cilat në mënyrë kategorike duhet të pezullojnë të gjitha rekrutimet dhe të sigurojnë që këto rekrutime do të jenë ekskluzivisht vetëm nga portali.

Gjithashtu, edhe agjencia e re që po krijohet, e cila do të ketë në gjendje edhe burimet njerëzore për t'i ndërmarrë këto procese, sepse me burimet aktuale në ministri është e pamundur që ne të mbikëqyrim çdo proces rekrutimi dhe t'i menaxhojmë në mënyrë individuale të gjithë ofruesit e arsimit profesional. Pra, ne duhet të kemi burimet e nevojshme që ky proces të ecë ashtu siç duhet.

Sa i takon rastit të Bulqizës, do ta diskutojmë sërish kur të vijë buxheti i 2020-s, sepse përsëri do të jemi të pranishëm në këtë komision dhe do të mundohemi me të gjitha forcat që shkolla e Peshkopisë të jetë në listën e investimeve të këtij viti.

Sa i takon pjesës së punësimit të atyre që janë diplomuar në Bulqizë, ne nuk i detyrojmë dot bizneset të marrin në punë ata që janë diplomuar. Kjo është pjesë e analizës paraprake, të cilën e kemi të domosdoshme për ta bërë, nëse sektori privat ka nevojë reale për të thithur krahë pune të kualifikuar apo duhet ta bëjmë paraprakisht, para se të hapim një drejtim dhe më pas të mos kemi mundësi që këta individë të integrohen në tregun e punës.

Fjalën po ua kaloj kolegëve.

Stavri Lako – Në lidhje me propozimin që bëri zonja Adelina për krijimin e një shkolle pilot në fushën e bujqësisë dhe të veterinarisë, kjo po realizohet me shkollën “Rakip Kryeziu”. Javën që vjen do të vijë përfaqësia e rajonit të Emilia Romagna, që ka fituar procedurën për zbatimin e projektit. Janë 5 milionë euro, të cilat do të investohen kryesisht në shkollën “Rakip Kryeziu” për kthimin e saj në një shkollë model, me konvikte e të gjitha gjërat, në mënyrë që të bëhet atraktive jo vetëm për zonën e Myzeqesë, por për të gjithë Republikën.

Elira Demiraj – Meqenëse logjika shkon në pjesën e financimeve, siç shihet, zërat për të cilat flitet kur kemi të bëjmë me një shkollë profesionale janë zëra shumë të mëdhenj, që do të thotë se edhe kur vjen koncepti i riorganizimit, nuk mund të flasim për disa shkolla ose shkollë për çdo bashki, por flitet shkollë për rajon, shkollë për ofertë ekonomike. Nga pikëpamja e numrit të nxënësve që ofrojmë, duhet të keni parasysh se nuk kemi kaq shumë të rinj, por duhet menduar edhe nga pikëpamja e eficiencës që të bëjmë një shkollë, ku të kemi parasysh numrin e të rinjve, trendin demografik dhe të gjitha. Për këtë arsye, pak më parë preka edhe pjesën e optimizimit, që ne do të marrim parasysh një sërë faktorësh, të cilat do të analizohen me qëllim që, kur të vijmë te vendimmarrja që shkolla e arsimit profesional të ngelet shkollë multifunksionale e specializuar për një ofertë të caktuar në treg apo qendra të formimit profesional, do të jetë hap shumë i shpejtë i bazuar në shumë studime dhe evidenca. Mbi bazën e këtyre diskutimeve do të marrim një vendim dhe jo në bazë diskutimesh që vijnë edhe nga problematikat që shfaqen për çdo rajon. Ne jemi pro këtij diskutimi.

Ajo që morëm shënim është pjesa e konsultimeve, që do të bëhen edhe në prani të bashkive, mund të bëhen edhe në prani të Ministrisë së Arsimit dhe grupeve të interesit që, kur ne ta kemi këtë plan, të bëjmë organizimin me deputetët e zonës, që të kemi një *feedback* sa më gjithëpërfshirës, ku të japim një mesazh për vizionin e riorganizimit, që të jemi të gjithë në të njëjtën faqe të informimit.

Lidhur me pyetjen për bashkëpunimin me bizneset, siç e dini, formimi profesional ka një sërë mënyrash, ka nga ato që janë të bazuara vetëm në profilet shkollore, ka nga ato që janë të kombinuara shkollë dhe praktika profesionale, të cilat mund të jepen brenda shkollës, por mund të jepen edhe nga bizneset në të tilla raste. Kjo kërkon një procedurë për të cilën po punohet dhe përmirësohet që të jepet në mënyrë të uniformizuar dhe të ketë monitorim procesi.

Edhe te pjesa e skelet - kurrikulave në strategji është parë pjesa e rishikimit të ofertës arsimore si në shkolla dhe formim profesional. Këta hapa janë të shënuar në rishikimin e strategjisë të gjitha. Ne mund ta japim këtë në raport me shkrim.

Për pjesën e disa prej kurrikulave të formimit profesional, kemi evidentuar që janë 20 kurrikula në nivel kombëtar dhe janë 70 % e ofertës që jepet në kurset e formimit profesional, e miratuar nga Agjencia e Kualifikimeve. Për pjesën tjetër të kurrikulave, që bëhet në nivel qendrash formimi profesional, është rishikuar e gjithë metodologjia, e cila ka filluar të aplikohet tashmë.

Kur marrim kërkesa të tilla si përpunimi i qumështit, që përmendi zotëria, do të thosha se jemi në një proces ku kurrikula do të ketë fleksibilitet, do të jepet në treg dhe do të shpërndahet në të gjitha qendrat që kemi.

Këto ishin pak a shumë përgjigjet për pyetjet bazë.

Faleminderit!

Stavri Lako - Në lidhje me mundësinë që individët, të cilët kualifikohen në vendin tonë, të kenë akses jo vetëm në tregun rajonal, por edhe më gjerë, siç e përmendi zonja Milva, vjet është miratuar ligji i kornizës shqiptare të kualifikimeve dhe një grup pune po punon për referencimin e kësaj kornize me kornizën europiane të kualifikimeve, që është një proces që do të hajë kohë. Në momentin që korniza jonë referencohet me KEK-un, që është Korniza Europiane e Kualifikimeve, presupozohet që individët që përfundojnë kualifikimet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por ne jemi duke punuar që ta institucionalizojmë.

Dajna Sorensen – Pjesën e kontratave për praktikant profesional i kemi mbajtur shënim.

Kontratat për praktikant profesional, janë kompetencë e shkollave, megjithatë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po bëhet edhe një draftregullore për pjesën e...

Megjithatë, kemi praktika shumë të mira. Në disa nga shkollat e arsimit profesional nuk është uniform, por disa shkolla të tjera janë pararojë për sa i përket praktikës dhe variojnë shumë nga shkolla në shkollë, por edhe nga sektori në sektor.

Në qoftë se flasim për hoteleri – turizëm apo për IT, praktikat profesionale në kompani janë reale, domethënë, aty ku sektori privat është duke evoluar dhe ndjen një nevojë reale përkrah punës së kualifikuar, ato praktika profesionale po ecin shumë mirë pranë ndërmarrjes, sepse kanë një interes real për t'i marrë këta individë për t'i punësuar. Për sektorët nuk mund të themi të njëjtën gjë, është shumë e vështirë të ketë edhe praktika profesionale që janë po aq domethënëse sa në sektorin e turizmit apo në IT.

Stavri Lako – Lidhur me komentin e zotit Fadil, drejtuesi i shkollës, në radhë të parë, duhet të jetë menaxher. Nëse është një njeri i shkathët, e bën këtë gjë, është proaktiv, i troket biznesit dhe është pozitiv, kur dikush e bën një gjë të tillë.

Fatjona Dhimitri – Këtu po e mbylлим seancën dëgjimore për sot.

Ismet Beqiraj – Zonja Zëvendësministre, ju falënderoj për përgjigjet, por bëre disa rumbullakosje, si zakonisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, duroni!

...lidhur me përgjigjet e pyetjeve të mia, kur bëhet fjalë për sektorë të vështirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatjona Dhimitri – Ndjesë, Ismet, për arsye të organizimit të axhendës dhe punës sime, jam e detyruar t'ia kaloj fjalën zonjës Milva.

Ismet Beqiraj – Ju lutem, më lejoni!

Nuk jam dakord që shkollat profesionale ngrihen vetëm sipas ofertës dhe kërkesës, por ka një program dhe strategji për zhvillimin e burimeve energjetike. Ne do ta gazifikojmë Shqipërinë. Pse nuk ka kërkesë dhe ofertë për këtë treg, që specialistët të përgatiten për 3-4 vjet? Pse nuk bashkëpunojnë me organet e qeverisjes vendore, për ta ngritur e mbuluar këtë sektor edhe për industrinë e naftës paralelisht? Ndaj thashë atë rumbullakosjen.

Së dyti, lidhur me një shqetësim që u shpreh se në miniera dhe sektorë të tjerë futen njerëz pa profilin përkatës. Për çfarë është Inspektorati i Punës?! Në çdo kompani, detyra numër një kur bën një plan biznesi, është që vendosë në organigramën e tij se ka qak inxhinierë, qak specialistë. Këto duhet të kontrollojë Inspektorati i Punës, në mënyrë që industria të jetë

në dorë të profesionistëve, sidomos në drejtim të sektorëve të rëndësishëm strategjikë energjetikë dhe minierave.

Milva Ekonomi - A mund ta marr unë fjalën dhe t'ju them se do ta drejtoj unë mbledhjen për këto pak minuta që kanë mbetur?

Së pari, faleminderit shumë, Daina, dhe gjithë grupit që ishit këtu! Komisionit tonë i përcillni shumë kënaqësi kur vini, se arrijmë të kemi një komunikim shumë të mirë.

Unë nuk bie dakord fare me fjalën “rrumbullakosje”, sepse nuk...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ju ndërpreva, Ismet, mos e bëni as ju!

Nga pyetjet që u bëmë ne, si anëtarë komisioni, atyre që janë përballë nesh, u krijuam konfuzion dhe nuk arritëm t'u tregojmë se duam 61 shkolla profesionale, pra një njesi ne cdo bashki, apo optimizim të formimit profesional në vend.

Së dyti, që është shumë e rëndësishme, duhet të kemi parasysh një gjë, kur na vjen këtu ekzekutivi, ai është pa ngjyrë politike, bën vetëm detyrat që u kanë caktuar, strategjitë, vendimet e Këshillit të Ministrave, ligjet dhe programet e donatorëve. E mira është që kemi këtë lloj ekzekutivi përballë dhe sa herë bëjmë mbledhje, marrim përgjigjet që duam të marrim prej tyre.

Së treti, që është po shumë e rëndësishme për ne, ky lloj diskutimi nuk ka ndodhur vetëm një here. Ne, si komision, kemi rënë dakord për ta thirrur disa herë këtë panel për të marrë vesh si po shkon arsimi profesional dhe në momentin që bëjmë pyetje, duhet të kemi parasysh që disa gjëra të hollësishme, që mund t'i dimë nga lidhja që kemi me një biznes, nuk janë pyetje për panelistët. Pra, të mos kalojmë në ekstremin e detajeve, kur ato detaje nuk janë puna jonë. Kështu që duhet ta kemi parasysh këtë gjë. Me këtë grup paneli ne do të takohemi sërish, se po afron buxheti dhe aty do të bëjmë përsëri të njëjtat diskutime se ku dhe si do të shpërndahen paratë, dhe duke bërë përpjekje se si do të shpërndahen ato, natyrisht që kemi arritur të realizojmë disa gjëra.

Lidhur me shkollat bujqësore, është një shkollë në Gole, m që ka mbledhur nxënës nga e gjithë Shqipëria. Shkollat që kanë të bëjnë me gazifikimin, nuk janë krijuar ende. Ndërmarrja e plotë e gazifikimit të Shqipërisë ka procese të gjata, por mendohen të ndërtohen. Ne jemi duke i ndjekur hap pas hapi të gjitha dinamikat e zhvillimit ekonomik, që po kalon Shqipëria.

Dua t'ju kujtoj edhe një herë për shënimet që morët nga kryetarja lidhur me materialet që duhen sjellë me shkrim. E dimë që jeni të rregullt si gjithmonë dhe i sillni materialet në kohë.

Faleminderit dhe mirë ardhshi në takimin tjetër!

Komisioni do të qëndrojë edhe një minutë këtu.

Kalojmë në një çështje tjetër, që ka të bëjë me kalendarin e punës së komisionit. Ne kemi pasur një ligj, që u tërhoq në kalendar, për AMA-n dhe për tregtinë elektronike, ndërkohë që puna në komision vazhdon me ligjin “Për Rininë”. Për këtë ligj ju kujtohet që kemi bërë dëgjesa, ndërkohë kishte kaluar te Komisioni i Ligjeve për dhënie mendimi, por që ende nuk e ishte parë prej tij. Komisioni i Ligjeve javën e kaluar e mbylli diskutimin e vet për të. Komisioni ynë tani do të bëjë diskutimin nen për nen dhe në tërësi, pasi diskutimin në parim e kemi bërë dhe kemi dëgjuar të gjitha grupet e interesit.

Ndaj, do t’i lutesha shumë sekretarisë së komisionit që të mbajë shënim qëndrimet e Komisionit të Ligjeve për këtë ligj dhe ne të fillojmë punën. Jam e mendimit që ditën e hënë, pas mbledhjes së grupit, në orën 11.00, të bëjmë mbledhjen për diskutimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për Rininë”.

Ju e dini si ka ndryshuar Rregullorja, duhet dorëzuar 4 ditë para seancës raporti.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ndërsa java tjetër është java e gjelbër, ndërkohë kemi lënë edhe një dëgjese me ministren e Kulturës dhe ne të katërt në këtë rast nuk jemi ulur për të bërë kalendarin e vizitave.

Edhe në qoftë se nuk jeni ju, thërrasim zëvendësuesin, pastaj për gjërat e tjera do të biem dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne dëgjesat i kemi mbaruar, vetëm se Komisioni i Ligjeve nuk kishte sjellë ende opinionin e vetë.

Faleminderit! Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA